



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 16/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për rehabilitimin e pjesshëm të përroit në Lagjen e Re Loti III dhe rehabilitimi i pjesshëm i Përroit Dukas Loti II”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale ndërtimi dhe produkte ndihmëse për ndërtimin 44

VLERA E FONDIT LIMIT 5,361,017.5 (pesë milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëmbëdhjetë pikë pesë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga burimet e veta dhe buxheti i shtetit për vitin 2026, për objektin: **“Blerje bazë materiale për rehabilitimin e pjesshëm të përroit në Lagjen e Re Loti III dhe rehabilitimi i pjesshëm i Përroit Dukas Loti II”**

Nga të cilat:

4.061,836.6 (katër milion e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH nga buxheti i shtetit.

1,299,180.9 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë pikë nëntë) lekë pa TVSH nga burimet e veta.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$5,361,017.5 \times 40\% = 2,144,407 \text{ Lekë.}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

5,361,017.5 x 20% = 1,072,203.5 Lekë..

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj se merr përsipër furnizimin (dorëzimin ngarkimin dhe shkarkimin) e mallit objekt prokurimi me kostot e veta, të cilat do të dorëzohen në

magazinën e Bashkisë Patos ndrësë zëri “Beton C12/15 (me çakell) (Per veshjen e kanalit, t=10cm)” do të hidhet në objekt ne objektet përkatësë në prani të komisionit të ngritur për marrje në dorëzim, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Materialet e kërkuara duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të cilat duhet të jenë së bashku me faturën shoqëruese të mallit, çdo material do të vlersohet dhe miratohet para marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës dhe transportin e materialit, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia e kërkuar
1.	Pompë betoni	Pronësi ose me qira	copë	1 (një)
2.	Autobetoniere	Pronësi ose me qira	copë	2 (dy)
3.	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	Pronësi ose me qira	copë	2 (dy)

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
- leje qarkullimi;
- certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:

- kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiduereshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu

furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës dy mjetet të cilët do të shkarkojnë materialin në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera.

Specifikime teknike

- **Beton C12/15 për veshjen e kanalit**

- **Çakëll (Granil për betone)**

- Material i thyer, i pastër, pa materiale organike, baltë apo argjilë.
 - Fraksioni i lejuar është deri në 20mm. Forma e kokrrës duhet të jetë këndore ose poligoniale, e thyer.
 - Treguesi i Los Angeles (rezistenca ndaj konsumit) jo më i madhe se 25.
 - Rezistenca në shtypje jo më pak se 800kg/cm².

Materiali duhet të plotësojë kërkesat e STASH 539-87 “Për punime ndërtimi”.

- **Çimento 32.5N**

Çimento 32.5N duhet të jetë në përputhje me EN 206-1 dhe EN 197-1. Çimento Portland me shtesa gëlqërore CEM II/B-LL, sipas EN 197-1. Të jetë e ambalazhuar për t’ju rezistuar kushteve të magazinimit në ambiente ku përqindja e lagështirës është e lartë. Kollitë të jenë me paleta druri dhe të mbështjella me plastmas.

- **Rërë e larë (inerte të imta)**

Inertet e imta konform STASH 512-78 do të jenë prej rëre natyrale, gur të shoshitur. Inertet e imta të marra nga gur të shoshitur duhet të jenë të mprehtë, kubikë, të fortë. Inertet e imta duhet të jenë në një cilësi shumë të mirë nga rëra e brigjeve. Ajo duhet të jetë e pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga më e holla deri tek më e trasha, pa copëza nga argjila, rëra, plehra apo cifla të tjera. Nuk duhet të përmbajë më shumë se 10 % të materialit më të hollë se 0.10 mm të hapësirës në rrjetë, i gjithë materiali duhet të kalojë në një rrjetë 10mm.

- **Uji për çimento**

Uji i përdorur për beton duhet të jetë i pastër, i freskët dhe pa baltë, papastërti organike vegjetale dhe pa kripëra dhe substanca të tjera që ndërhyjnë ose dëmtojnë forcën apo durueshmërinë e betonit. Uji duhet të sigurohet mundësisht nga furnizime publike dhe mund të merret nga burime të tjera. Nuk duhet të përdoret asnjëherë ujë nga gjermimet, kullimet sipërfaqësore apo kanalet e vaditjes. Vetëm ujë i aprovuar nga ana cilësore duhet të përdoret për larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe për qëllime të ngjashme.

Raportet e inerteve të trasha dhe të imta:

Raporti më i përshtatshëm i volumit të inerteve të trasha në volumen e inerteve të imta duhet të vendoset nga prova e ngjeshjes së kubikeve të betonit. Mund të bëhet edhe prova në kubikët e marrë si kampione dhe të shënojnë inertet dhe fraksionimin e tyre, përzjerjen e betonit në fillim të punës dhe kur ka ndonjë ndryshim në inertet e imta apo të trasha ose në burimin e tyre të furnizimit. Këta kubike duhet të testohen në laborator në kushte të njehta, përveç rasteve të ndryshimeve të vogla në raportet përkatëse të inerteve të imta dhe të trasha (lart apo poshtë) nga raporti më i mirë i arritur nga analizat e sitës. Kubikët duhet të testohen nga 7 deri 28 ditë.

Metoda e përzierjes

Betoni duhet të përzihet në përzieresa mekanikë të miratuar që më parë. Përzierësi, hinka dhe pjesa përpunuese e tij duhet të jenë të mbrojtura nga shiu dhe era.

Inertet dhe çimento duhet të përziejehen së bashku para se të shtohet ujë derisa përzierja të fitojë ngjyrën dhe fortësinë e duhur. Duhet të largohen papastërtitë dhe substancat e tjera të padëshirueshme. Uji nuk duhet të shtohet nga zorra apo rezervuare në mënyrë të pakujdesshme. I gjithë betoni duhet të përzihet uniformisht në fabrika moderne përzierjeje për prodhimin maksimal të betonit të nevojshëm për plotësimin e punës brenda kohës së përcaktuar pa zvogëluar kohën e nevojshme për përzierje. Betoni duhet të përzihet në përziersa betoni për kohëzgjatjen e kërkuar për shpërndarjen uniforme të përbërësve për të prodhuar një masë homogjene me ngjyrë dhe fortësi, por jo me pak se 1-1/2 minutë. Përzierësi duhet të përdoret nga punëtorë të specializuar që kanë eksperiencë të mëparshme në drejtimin e përdorimit të përzierësit të betonit. Me mbarimin e kohës së përzierjes, përzierësi dhe të gjitha mjetet e përdorura do të pastrohen mirë përpara se betoni i mbetur në to të ketë kohë të forcohet.

Në asnjë mënyrë nuk duhet që betoni të përzihet me dore.

- **Zgarë hekuri Ø6**

Zgara e përbërë me shufra Ø6 do të vendosen me hap 15 cm në të dyja drejtimet do të përdoret si armaturë e shpërndarë për shkak të ngarkesave jo shumë të mëdha. Lidhja e shufrave është e fabrikuar. Rrjeti standart është 15x15cm me përmasa 5x2m.

- **Gjeotekstil 180 gr/m²**

Gjeotekstilet do të jenë pëlhura të endura dhe përbëhen prej një zinxhir të gjatë me filamente polimerike ose fije të tjera si polipropileni, polioetileni, poliesteri, poliamidem ose poliviniliden-klorid të formuar në një rrjet të qëndrueshëm të tillë që filamentet ose fijet të qëndrojnë në pozicionet e tyre dhe të jenë të lirë nga defektet apo dëmtime. Këto pëlhura do të jenë rezistente ndaj dëmtimit për shkak të ekspozimit ultraviolet, temperaturës së ambientit, kripës, kushteve të acidit dhe alkalitit vajrave mikroorganizmave dhe insekteve.

1. Orientimi i Makinerisë. Drejtimi i gjatë i gjeotekstit. Drejtimi i makinerisë kryq 90 (ose mbushja) është pingul me drejtimin e makinerisë.
2. Vlera mesatare e rrotullimit. Vlera mesatare e rrotullimit të çdo karakteristike specifike gjeotekstit është mesatarja e rezultateve të testimit nga çdo rrotullim brenda një shume.
3. Gjeotekstil jo i thurur. Një tekstil i prodhuar nga bashkimi ose nderthurja e fibrave, ose të dyja bashke, të kryera me mekanik, të ngrohjes ose kimike.
4. Toleranca e Tegelit. Distanca minimale nga buza e gjeotekstit në lënin e thurjes me të afërt me atë buze.
5. Tipi i Tegelit. Një përcaktim që lidhet me karakteristikat thelbësore të pozicionimit të gjeotekstit dhe rrjeshtat e qepjes në shtresa të qepura të përcaktuara, siç tregohet në plan.
6. Pjesa anësore. Buza e përfunduar e një gjeotekstit paralel me drejtimin e makines.
7. Tipi i Thurjes. Një përcaktim që lidhet me karakteristikat thelbësore të gërshetimit të fijeve të qepjes në një shtresë të caktuar, siç tregohet në plan.
8. Gjeotekstile të endura. Një tekstil i përbërë nga dy ose më shumë grupe filamentesh ose fijesh të ndërthurura në një formë të tillë ku krijojnë një strukturë uniforme.

- **Çakëll makinerie (Inerte të trasha)**

Çakulli i makinerisë është material me përzierje granulometrike 10~30mm me përbërje të grimcave argjilore jo më tepër se 10%, dhe pas hapjes në objekt behet ngjeshja me pajisje.

Furnizimi i sasive dhe përbërjeve granulometrike të çakullit të makinerise do të bëhet sipas përcaktimeve të Bashkise Patos, në varësi të sasisë së nevojshme për nënshtresën në shtratin e përroit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Ermengjecave Civile** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **27/07/2026, ora 09:00**.

I. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bazë materiale për rehabilitimin e pjesshëm të përroit në Lagjen e Re Loti III dhe rehabilitimi i pjesshëm i Përroit Dukas Loti II**”.**

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Boreta Murati

Imela Halimi